



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 31-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.06.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Fadil Sopa, anëtar
7. Sami Bytyqi, anëtar
8. Fitim Shala, anëtar
9. Rinor Murati, anëtar
10. Armend Grajqevci, anëtar
11. Gentianë Hoxhaj, anëtare
12. Venhar Agushi, anëtar
13. Xhyla Dedushaj, anëtare
14. Lulzim Rrustemi, anëtar
15. Herolind Kozhani, anëtar
16. Ardit Cani, anëtar
17. Arsim Jashari, anëtar
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
20. Ganimete Qeriqi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Fitim Meziu, anëtar
23. Fadil Spahiu, anëtar
24. Fatmir Fetahu, anëtar
25. Shahadije Dragaçina, anëtare
26. Besiana Sylja, anëtare
27. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Shkelzen Hajdini, DSH
5. Elmaze Behluli, DA
6. Sead Aliu, DI
7. Rexhep Rexhepi, DBP
8. Rasim Hasani, DA
9. Safete Amerrlahu, DGJK
10. Burim Krustemi, DSHPMSH
11. Imri Semetishti, DUPMM
12. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
13. Flamur Sylejmani, DI
14. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, po ashtu tha se me propozim te ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së, e keni edhe një pikë shtese të cilën e keni pranuar përmes emailit dhe ne forme fizike tani, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 29-të (e Jashtëzakonshme) dhe 30-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
3. Propozim Vendim mbi rialokimin e mjeteve buxhetore të mbetura nga të hyrat vetanake.
4. Informatë lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031.
5. Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Lipjanit 2024-2027.
7. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
8. Propozim vendim për miratimin e rezervës komunale për vitin 2024

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditë së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 22 vota për u aprovua rendi ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se i kam disa kërkesa ,disa pyetje dhe një propozim, e para është një kërkesë e banorëve të fshatit Magure për pastrimin e shtratit të lumit ne gjatësi 100 metra. Kërkesa e dytë ka të bëjë nga banorët e fshatit Varigovc për ndriçim publik dhe asfaltimin e rrugicave. Kërkesa e tretë nga banorët e fshatit Bujan,e para për rrugën Nuhi Bajrami qe ka mungese te trotuarit dhe ndriçimit dhe e dyta bllokimi i kanalizimit te varrezat qe po shkakton probleme, rruga drenicaket. Kam një kërkesë te banorëve te lagjes Dugolli nga Harilaqi, pjese e territorit te komune se Lipjanit, për ujë të pijes. Kërkesë për DSHP rreth policëve te shtrirë çka po ndodh me atë kërkesë, pasi qe vendosja e policeve te shtrire ne rrugën Haxhi Kleçka , ka qen një veprim qe duhet përshëndetur. Ne rrugën Bnaullë Bujari është dëmtuar trotuari, pasi qe ka rrëshqit dheu. Si ka mundësi qe një kat ilegal i një ndërtese te ndërtohet dhe nuk e verën askush. Si ka mundësi mu ndërtua një kat mos me vërejt askush. Pyetje për DKA-në, e kam vizituar shkollën e Bnaullës dhe aty kemi parë, qe ka rregull, disiplinë pastërti por ka nevojë për vendosjen e dy klimave pasi qe eshët vape e madhe. E kam një vërejte për raportin e drejtorve te ekzekutivit ku kane forma te ndryshme dhe kane gabime si gjuhësore, teknike po ashtu edhe përmbajte jo te mire. Dhe e fundit e kam një shqetësim për punësim familjare dhe partiake qe po ndodhin ne komunën e Lipjanit, ku është krijuar një klime e keqe te qytetarët dhe kjo është bere e tepërt.

Ardit Cani, tha se kam disa çështje për ti ngritur, e para ka të bëjë me vendosjen e pengesave në Baincë dhe Resinovc , pasi qe po vozitin me shpejtësi te madhe. E dyta kërkesë për vendosjen e shenjave qe ndalojnë hedhjen e mbeturinave nëpër fshatra, ku do ti ndalonte deponite e mbeturinave. E treta kërkesë për zhavorrimin e rrugëve bujqësore në Baincë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se kam disa kërkesa, e para mungesa e ujit të pijes në fshatin Sllovi te cilën kanë mungesë te ujit të pijes qe disa vite. E dyta, në Lipjan çdo dit po rritet numri i banorëve, por edhe kompania pastrimi duhet qe ta shtoj numrin e kontejnerëve si dhe shpeshimin e mbledhjes se mbeturinave. Tjetra, zhurma e madhe, apo zëri i lartë i muzikës i lokaleve në orët e natës qe është shqetësim i qytetarëve qe jetojnë ne shesh. Prandaj duhet komuna me marr hapa. E fundit, për kryesuesin e Kuvendit, dje kemi mbajt takimin e komitetit për komunitete dhe anëtarët e komitetit te cilët nuk jen pjesë e kuvendit nuk kane marr mëditje nga muaji i kaluar dhe nuk do te paguhen, a jeni ne dijeni ju si kryesues, nëse është e vërtet ju si komune jeni te obliguar ti paguani dhe nuk duhet te rrini duarkryq.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se unë nuk kam shkresë, por i pyes zyrtarët përgjegjës. Por kjo është një problematike që është tu ndodhe në të gjithë Kosovën, e kemi edhe KKSBB-në, që nuk po paguhet dhe është çështje që është ngritur disa here në nivel qendror dhe nuk po e marrin parasysh.

Egzona Bytyqi, tha se unë se pari kam disa propozime, e para që katër QKMF-të, Magure, Gadime, Shalë, Janjevë, të pajisen me ultrazë. Propozimi dytë të filloj me vizita sistematike të nxënësve në shkolla fillore dhe të mesme. Propozimi tjetër që karshi analizave që bëhen në QKMF, të inkorporohen edhe 3 analiza për gjëndrat tiroide. Çështja tjetër të filloj procesi i rekrutimit të logopedit edhe pse me sa po shihet nga niveli qendror është vështirë se me sa morra info prapë është kthyer statuti dhe kjo është shqetësuese. Tjetra, segmenti i rrugës rajonale Magure- Sllatine e cila është në gjendje shumë të keqe. Për DSHP, në vitin 2021 kemi filluar me themelimin e ndërmarrjes Ulpiana, ku ka mbetë si çështje e a keni informata. Tjetra, unë e kam vizituar parkun industrial në Qylagë, dhe e kam parë që aty zhvillimet po ecin ngadalë. Për fund e kam një propozim ose lutje që të bëhet një shtëpi për qëndrim ditë që do të ishte domosdoshmëri e kohës.

Lulzim Rrustemi, tha se i kam disa pyetje dhe disa kërkesa, e para për DPUMM, kam pyetje po zhvillohen ndërtime të larta në rrugën Zylfije Gashi e cila zonë ka ndalesat e veta dhe me tutje po ndërtohet në këtë rrugë, apo zbatohen harta zonale në këtë rrugë ose jo? E dyta kërkesë për Inspektoratin ku në mëngjes shihet në rrugë që është ose e baltosur ose e lagur dhe kjo si pasoje e bazës së asfaltit të bagerit apo fabrikës së stiropollit. Inspektorati duhet me bërë inspektim apo përdoren filterat. Kërkesë për DKA-në nga disa prindër e në shkollën “Vëllezërit Frashëri” mos të ketë në klasa nga 40 nxënës, të bëhet një plan i veprimit dhe të bëhet një zgjidhje. Kërkesë të banorëve të Rufcit dhe fshatrave për rreth pers sanimin e ujërave të zeza ku disa hektarë kanë mbetë të pa punëshme, duhet se bashku me komunën e Graçanicës me bërë një zgjidhje.

Shahije Dragaçina, tha se kur u bë përrurimi i çerdhes në Rufc kryetari se pari e bëri njoftimin në profilin e tij facebook ndërsa me faqen zyrtarë të komunës del me vonesë. Po ashtu kam edhe një kritikë për zyrën për informim të komunës, si ka mundësi që të mbahet një mbledhje e komitetit edhe nuk postohen të paktën çështjen me të rëndësishme, siç ka qenë rasti i fundit që është diskutuar për një çështje shumë me rëndësi e platformës SIS dhe asnjë fjalë për këtë çështje nuk është shkruar. Vetëm pse ka qenë një projekt i qeverisë. Po ashtu i kam edhe disa ankesa të banorëve të Janjevës, për ndriçimi publik, nuk ka ujë të pijes, si dhe transporti Janjevë Prishtinë. Tjetra e jeni të njoftuar për një incident që ka ndodhë në shkollën e Gadimes ku një

nxënës është rrahur nga drejtori i shkollës. Tjetra a janë marr masa ndaj drejtorit të Janjeves që ka lejuar të mbyllën notat 10 dite para përfundimit të procesit mësimor nga një mësimdhënëse.

Ganimete Qeriqi, tha se një dukuri e pa arsyeshme po ndodhe ne shoqërinë tone kryesisht ne QKMF, për punëtorët e shëndetësisë ku ligji ua njih pagën e 13-të, mirëpo kjo nuk është realizuar kurrë, ata ju kanë drejtuar gjykatës mirëpo komuna nuk e ka realizuar, komuna e ka obligim me u kujdes ndaj këtyre punëtorëve.

Rinor Murati, tha se kam disa kërkesa e para rruga dhe trotuari për të xhamia e Lipjanit është dëmtuar dhe është ne gjendje jo të mirë dhe është një nevojë urgjente për rikonstruktim. Kërkesa e dytë është që të ndalohet parkimi i veturave ne rrugën Skënderbeu pasi që tash vijnë mërgimtarët dhe po shkaktohen kolona. Dhe një pyetje kur pritet planifikimi i punimeve në hekurudhe.

Besiana Sylja, tha se i kam dy kërkesa, e para ka të bëjë për dezinfektimin e hapësirave publike në qytetit të Lipjanit për eliminimin e mizave dhe mushkonjave. E dyta, të bëhte pastrimi i rrugëve por edhe i atyre dytësore, pasi që disa rrugë nuk po pastrohet siç është ajo Mbreti Zog, ku qytetarët po ankohen.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, se të gjitha problemet nuk janë të zgjidhura ne teren, po përpjekjet tona janë që ta vejmë një rend për kryerjen e këtyre punëve sipas peshës që kanë dhe sipas mundësive buxhetore. Është mirë me lexua statutin e komunës dhe me i pa përgjegjësitë e kryetarit të komunës. Shtrati i lumit ne Magure, është pjesa fundore pa u përfunduar dhe jemi të interesuar me krye dhe do ta kryejmë, por fshati ka pas prioritete tjera. Por është mirë mos me ra pre e inskenimeve të qytetarëve. Ne Vargovc do të kryhet ndriçimi publik. Ka nevojë për trotuar Bujani dhe disa fshatra tjera, por ne disa fshatra kemi probleme pronësorë. Uji i pijes kemi mungese edhe ne objektin e komunës dhe me ujë menaxhon qeveria dhe ne as aksionar nuk kemi ne ujësjellës. Pengesa ne rrugë ka nevojë ne shume rrugë, por nuk kemi mundësi në çdo vend me i vendos, por do të vendosen afër shkollave xhamive. Ne jemi duke e bërë një evidentim për parkim të veturave përpara shtëpive të të pamës apo xhamive. Për klima ne shkolle se kam pas si ide por ne këtë kohe janë nxënët ne pushim por mund të kryehut ajo. Unë as një familjar të asnjë drejtori nuk e kam shti në punë dhe ne kemi pas kujdes edhe të subvencionet edhe pse ligji nuk e përjashton. Tabelat për ndalimin e mbeturinave mund të vendosim në vendet me kryesore. Shportat e mbeturinave jemi duke e bërë një rivendosje të shportave dhe kushdo që nuk ka shporte të mbeturinave mund ta marr shportën vetëm duhet në shkruar kontratën. Deponia të shtegu i biçikletave ka filluar të zhvendoset. Zhurma ne shesh

pas orës 23 është përgjegjësi i inspektionit dhe e policisë. Unë kam qen javën e kaluar por nuk kam pa qe ka pas zhurme. Për pagese te komitetit nuk kam dëgjuar ende, ndërsa KKSB-ne dhe komisionet tjera nuk po mundem mi paguar. Shëndetësia vitin e ardhshëm e ka te rritur buxhetin 100% ne mallra dhe shërbime dhe mund ti vendosim edhe ato 3 lloje të analizave, po ashtu edhe ultrazërin mund ta fusim. Rruga Magure Aeroport është rruge regjionale dhe shume e dëmtuar eshë rruge M,22, Njëjtë e kemi rrugën QMI-Lipjan. Parku kërçeva po shkon ngadalë, po përpjekkemi me i instaluar kamerat, por parku do te jete funksional. Qendra për persona te moshuar, kemi vështir te gjendemi hapësirë por mund ta shfrytëzojmë QKMF-ne kur te dalim ne objektin e ri. Harta zonale janë duke u zbatuar. Ndotja e ajrit nuk e di a është kompetencë e jona. Numri i nxënësve do te rregullohet nga 1 shtatori dhe do ta zgjidhim si problem. Deklarata e kryetarit para lajmit te komunës, ndoshta duhet njëherë, komuna me shkruar lajmin tani kryetari me thënë. Gjithmonë përcillet aktiviteti kryetarit pastaj del lajmi. Pastrimi i varrezave është lidhe kontrata dhe kane filluar para disa dite puna ne teren. A mbyllen notat para a pas kohe nuk është punë e kryetarit. Paga është pasoje e kontratës kolektive jo vetëm ne shëndetësi po arsim dhe tjerat. Trotuari ne Lipjan eshët kryer por duhet ajo rruge ne tersi te punohet deri te xhamia nga rreth rrotullimi. Nevoje e rregullimit te parkingjeve shume e nevojshme ne Lipjan. Mirëmbajtja shumë e nevojshme por nuk po kemi mundësi te gjitha mi mirëmbajtje, Dezinfektimi nuk kemi qysh ta bëjmë. Pse nuk është bere ende kompania Ulpiana, ne jemi duke prit qe 3 vete te gjitha kriteret i kemi plotësuar, nuk na aprovojmë vetëm pse jemi komunë qe udhëhiqet nga LDK-ja.

Arsim Jashari, tha se u pajtuam qe inspekcioni me dal me interesuar aty ku ka nevoje, ndërsa nëse ka banorë qe bëjnë inskenime duhet te lajmërohen ne polici.

Imri Ahmeti kryetar i komunës tha ne i kemi vendos kamerat ne Magure dhe kushdo qe bën inskenime do te shihet

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 29-të (e Jashtëzakonshme) dhe 30-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Lulzim Rrustemi, tha se e kam një vërejte është bere një gabim teknik, pasi qe po me figuron aty qe jam nënkryetar i komunës, është mire personalisht me ma qite rrogën si nënkryetar i komunës.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 29-të (e Jashtëzakonshme) dhe 30-të e Kuvendit, me vërejtjet e cekura me lartë pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 25 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 29-të (e Jashtëzakonshme) dhe 30 e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se e kemi KAP-in, 2025-2027 dhe kemi kohe për te diskutuar ende ne muajit ne vijim. Do te përpiqem ti nxjerri disa konstatime me kryesore. Vizioni i komunës është paraqitur ne dytribute e ato janë, lehtësirat e komunikimit dhe llogaridhënia. Janë paraqitur 4 prioritete janë forca ekonomike komunale, përmirësimi shëndetësor dhe i mirëqenies qytetare, përmirësimi i ambientit te komunës, krijimi i qeverise komunale. KAB eshët paraqitur edhe përmes fondeve burimore, ku çdo vit kemi nga pak ngritje. Te investimet kapitale janë 19 projekte. Prej tyre janë disa projekte te vogla dhe projektet e Parkut qendror se bashku me parking, ndërtimi i QKMF-së. Ndërtimi i qendrës se kulturës, stadiumet. Buxheti kryesisht do te shkoj ne projekte te mëdha. Ka mungese te investimeve ne Arsim, mungon uji i pijes ne disa vende si Topliqan, Kraishte, Bance dhe shume fshatra tjera. Asnjë projekt i trajtimit te ujerave te zeza, te urave, kjo ka nevoja shume për përmirësim. Shpresojmë qe do te ndryshohet ky buxhet ne qarkoren e dyte dhe do ti përfshije te gjithë sektorët, ne nuk do ta përkrahim kështu.

Shahadije Bikliqi, tha se pasi qe është korniza e pare dhe mund te ndryshoj, ku vetëm gjysme milioni euro do te shkoj ne fshatra për shkak te projekteve te mëdha rregullimit te parkut qendror, sheshit dhe parkingut. Ku kane mbet shume projekte

pa u përfshirëses fare. Me këtë buxhet janë mashtruar qytetaret dhe ky kryetar nuk ka arrit me ja siguruar gjerat elementare qytetarëve.

Besiana Syla, tha se KAB-2025-2027, nëse shihet ne vitin 2025 kemi një buxhet prej 25 milion euro ku kemi ngritje me krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa kemi ulje ne strukture ne paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunale, subvencione dhe transfere, ndërsa kemi rritje te investimet kapitale. Kam një pyetje tek zvogëlimet e kategorive ekonomike, prej pagave e mëditjeve e deri te subvencionet dhe transferet pse kemi zvogëlim. Keni dhe disa gabime teknike ne buxhet. Ne fshatin Banulle nuk ka asfaltim te rrugicave. Te rezervat e kam një vërejtje është dashtë te ndahet mjete për vendimet gjyqësorë.

Rinor Murati, tha se sa i përket KAB-it, janë për tu përshëndet edhe disa nga projektet ne dëgjime buxhetore qe janë organizuar, po i veçoj projektet nga lokaliteti nga vije si, rikonstruimi i rrugës Lipjan Rubovc, ndërtimi i trotuarit në Kojskë, ndërtimi i parkingjeve pranë shtëpive te komuniteteve dhe objekteve fetare, renovimi i QKMF-së për nevoja të OJQ-ve dhe personave me nevoja te veçanta. Ne grupi i LDK-së, e mbështesim këtë propozim.

Bashkim Budakova, tha se kam pyetje për përpiluesit e kësaj kornize buxhetore, nuk e pash asnjë projekt për vitin 2025 për lokalitetet Rubovc dhe Kojskë, edhe pse janë adresuar disa kërkesa. A ka arsye për mos përfshirjen e këtyre lokaliteteve me asnjë projekt të vetëm.

Egzona Bytyqi, tha se unë e ndaj te njëjtin shqetësim me kryetarin me zvogëlimin e numrit te punëtorëve në shëndetësi, për derisa ne po pretendojmë me e rrite gamen e shërbimeve dhe me ofrua shërbime sa ma cilësore gjithëpërfshirëse. Jam skeptik e nëse do te jetë gabim teknik ose jo. Sektorit te turizimit duhet ti ipet me shume prioritet sidomos ne Shisharke dhe Plitovic ku janë dy vende piktoreske dhe ka nevojë për investime.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se nuk na keni kritikuar vazhdimisht për mos pjesëmarrje ne dëgjime buxhetore, mirëpo kësaj here kam qen ne dëgjime buxhetore , mirëpo asnjëra nga kërkesat e mija nuk janë aprovuar. Kërkesat e mija ishin, blerja e mamografit për QKMF-, ndërtimi i shtatores se dëshmore Zylfie Gashit, rritja e subvencioneve ne shëndetësi me qellim te subvencionimit te nenave qe lindin foshnje, ndërtimi i qendrës për nevoja te veçanta, rritja e subvencioneve për zyrën për barazi gjinore dhe sigurimi i udhëtimit për nenat qe i dërgojnë fëmijët ne çerdhe publike ne

Gadime dhe Sllovi. Po pres qe ne qarkoren e dyte do te merren parasysh këto projekte. Po ashtu asnjë projekt nuk është parapare për fshatin Shalë.

Alban Salihu, tha se gjate fushatës premtohet ujë për qytetaret e komunës se Lipjanit pa i ditur kompetencat, ne baze te statutit, ndërsa tash edhe pse kërkesat për ujë janë publike, akuzohen asamblastët se nuk po i njohin kompetencat dhe statutin e komunës. Kemi një buxhet qe nuk ka gjithëpërfshirje dhe aspak kreativitet. Kemi asfaltim te rrugicave pa emër se cilat rrugica, ka gabime gjuhësorë shumë te mëdha.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se mund te ketë gabime gjuhësore, por me rendësi është përmbajtja se forma. Ne shkuarjen ne pension për zyrtarit për pension ky buxhet ka ardhë kështu, por tash është bere zgjidhje për ketë çështje. Ne fushatë paskam premtuar për ujë, por ju prape nuk po e dini qe me udhëzimin administrativ e nivelit qendror e ka ndryshua qasjen, tash na nuk kemi fare anëtar ne bord te ujësjellësit. Çështja e turizmit edhe Blinaja edhe shpella Gadimes nuk menaxhohen nga ana jonë. Zvogëlimi i punëtorëve një nder sfidat me te mëdha. Nuk është përjashtuar Rubovci nga projektet përkundër është rruga Lipjan Rubovc, qe është vazhduar. Një nder temat me te nevojshme është ndërtimi i një shkollë në Lipjan, por ne nuk e dimë a do te na shkojnë nxënësit siç e kemi rastin me shkollën Ismail Luma. Ne kemi aplikua për mamografi na është pranuar dhe shume shpejt do ta marrim. Pres me marr edhe donacione nga Demosi dhe organizata tjera vendore e ndërkombëtarë. Unë nuk e kam prit bash ne qet nivel mos me u përkrah nga niveli qendror Lipjani.

Arsim Jashari, tha se unë nuk pajtona qe me na e udhëheq Blinajën e Shpellën e Gadimes njerëz nga vende tjera, pasi qe ata nuk mujn ta dine se çfarë specifike munden me pas këto.

Alban Salihu, tha se Vetëvendosja ka ardh ne pushton ne vitin 2021, pse nuk është zgjedh problemi i ujit qe 8 vite. Sa i përket shkollës fillore, premtuhej ne atë kohe ndërtimi i një shkollë fillore, a eshët dite atëherë qe nuk do te shkojnë nxënësit ne shkollën e re apo jeni mashtruar.

Imri Ahmeti kryetar i komunës tha se kam përgjegjësi publike dhe penale për çdo veprim. Komune ka investuar dhe investon ne rrjetin e ujësjellësit, por nuk menaxhon me ujësjellës. Pavarësisht çka flitet qe 3 vite asnjë projekt nuk ka ardhne ne komune e Lipjanit nga kjo qeveri. Kjo qeveri po mundohet me na pengu ne çdo mënyre e me ketë i keni faktet.

Shahadije Bikliqiq, tha se kryetari brenda këtyre viteve mundohet ti ike përgjegjesisë ton kohen tu i përsërit te njëjtat gjera. Problemi është se qytetaret po përballen me mungese te ujit te pijes, duhet me ju bere zgjidhje jo me fol te gjitha te njëjtat fjale.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha, kërktoj nga ana juaj mos të ofendoni por ta respektoni rregulloren e punës së kuvendit dhe te flisni rreth temës.

Imri Ahmeti kryetar i komunës tha i nderuar kryesues, vazhdoni punimet e mbledhjes.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për,11 kundër, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim mbi rialokimin e mjeteve buxhetore të mbetura nga të hyrat vetanake.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha Latif Ramadani drejtor i DBF i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se kane filluar punimet te nënkalimi dhe parku qendror, unë ne kuvend pata kërkuar qe ne rrugën Mbreti Zog te futet ne buxhet trotuari me ndriçim publik për shkak se po rrezikohen këmbësoret ne atë pjese. Ne si grup do ta mbështesim këtë propozim.

Imri Semetishti tha se ne me kohe kemi filluar projektimin e kësaj rruge, mirëpo kjo rruge është diku gjerësi 4 metra e diku 7 metra dhe kjo na e vështirëson punën pasi qe duhet te hyjmë ne shpronësim.

Ardit Cani, tha se unë kam kërkuar qe te futet trotuari ne fshatin Baincë, ndërsa një projekt i mire qe janë përfshire rrugicat ne Risinovc.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha është mire qe janë hy shume projekte jo vetëm Risinovci. Ndërsa rruga Mbreti Zog eshët rruge qe është shume e ngushte vetëm 4 metra nuk e kemi fut ne buxhet se shpronësimi është i kushtueshëm dhe ka procedura. Ka shume projekte qe janë vitin e ardhshëm me donator dhe nuk janë këtu ne buxhet.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 3 kundër, aprovoi propozimin

IV

Informatë lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se plani zhvillimor për një komunë është shumë i rëndësishëm por kushtëzimi është shumë i rëndë edhe ata pas kohës, dhe unë këtë e shoh si shqetësim. Unë jam i propozimit që e anulojmë planin zhvillimor komunal dhe nuk e pranojmë deponi ilegale, nuk mujna na me lejua diçka që është e dëmshme si komunë e Lipjanit. Unë jam i gatshëm që të jem afër juve për këtë temë dhe kërkoj nga ana juaj mos lëshoni pe.

Armend Grajqevci, tha se një informatë shumë e rëndësishme, unë do të fokusohem te deponia regjionale e cila është e pa pranueshme të vendoset në atje pjesë si për komunën po ashtu edhe për banoret e asaj pjesë. Sa ka bazë ligjore që me u vendose ajo deponi pasi që aty janë shtëpitë afër 100 metra po ashtu ka ujë të pijes afër, është afër parku i blinajës, zona ekonomike afër aeroporti.

Alban Salihu, tha se nuk e di pse duhet me u përmend qeveria në kuvend, kjo mendoj që kjo është me shumë një lojë e qeverisë komunale për shkak se po dalin keq në sondazhe. Unë në baze të disa informatave me disa zyrtarë të ministrisë që i kam kryetari i komunës fillimisht ka hyrë në agjendën e kësaj deponie, mirëpo tash e ka pa se po humb vota dhe po e përdor për konsum publik. Kjo nuk është e drejtë.

Egzona Bytyqi, tha se unë vij prej atij lokaliteti dhe e shpreh shqetësimin tim personal dhe të banorëve të asaj pjesë, dhe aty po bëhet fjale për një deponi regjionale. Assesi nuk duhet të lejohet të behën ajo deponi pasi që afër është parku nacional është afër uji i pijes dhe me këtë na cenohet shëndeti. Dhe me këtë duhet të jemi të gjithë se bashku ta kundërshtojmë dhe mos të behet politike.

Lulzim Rrustemi, tha se një temë shumë e ndishme, por baza ligjore nëse vlen për dike duhet të vlejë për të gjithë, nëse plani zhvillimor dhe hapësinor nuk e ka

parapa ne afatin ligjor deponine në Lipjan. Aty eshët vendi me i papërshtatshëm ne Lipjan dhe i sjell dëme te ripararueshme Lipjanit dhe kjo nuk mund te ndodh sepse baza ligjore eshët në favor te komunës. Duhet me ju përmbajt shkresave anës ligjore.

Rinor Murati, tha se sa i përket këtij kushtëzimi unë e kam vetëm një dilemë, pse pikërisht ne Lipjan kjo deponi e mbeturinave.

Imri Semetishti, tha se pse ne këtë seancë e qitem janë dy fakte, e para sepse pezullimin e këtij projekti e kemi marr me 14 maj dhe e kemi nxënë seancën e pare dhe po e qesim informatën. Fakti i dyte është vendimi i kuvendit komunal qe e ka përcaktua periudhën 14 mujore për hartimin PZHK-së. Dhe mua dhe ekzekutivin na bene me zbatuar këtë vendim. Ne i kemi te kompletuara te gjitha fazat.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se drejtori, Imri sakte e shpjegoi çështjen, e para është dashtë me u përmbyll ky projekt sipas afatit ligjor ,e dyta kemi kontrate me kompaninë konsulentë për hartimin e këtij plani. Dhe nuk kemi mujt me ju përmbajt për shkak te zhegitjeve ne ministri. Unë takimin e fundit e kam mbajt ne Ministri dhe ju kam treguar qe kjo në mandatin tim nuk ka me u bo kur. Si ka mundësi me shti diçka ministria ne komunën tone kur nuk e ka ne plan zhvillimor. Tjetra si ka mundësi me u be kjo kur ne te nijetin vend investon ministria dhe komuna ne zonën ekonomike ne te njëjtin vend donë me qua deponi. Këta dhunshëm po donë me pru këtë deponi dhe i thërras qytetarët e asaj pjese mos me lejuar këtë deponi.

Alban Salihu, tha se unë po them po behte politike me diskursin, nëse jemi ne rregull me dokumentacion, ajo nuk behet por politike po bëhen këto fjalimet politike.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ne baza ligjore ne jemi ne rregull, por ata po e bëjnë kane filluar shpronësim e tokave ne atë pjese.

Imri Semetishti, tha se ne kemi përcjell te gjitha faktet e planifikimit hapësinorë, kjo deponi është ne kundërshtim me çdo norme ligjore sepse përfshihen në 5 vendbanimet me te mëdha ne Lipjan ku ka ndikim te drejtpërdrejt ne mbi 3 mijë banore, dhe aty ka ujëra nëntokësorë dhe ndikimi do te jete i jashtëzakonshëm dhe nuk mund te shfrytëzohet ai ujë, po ashtu distanca ndaj vendbanimeve, ne vije me zonën e licencuar ekonomike. Është jashtë standardeve te lejuara afër Aeroportit, afër parkut te Blinajës. Dhe te gjitha këto informata ja kemi përcjellë ministrisë.

Pastaj u kalua ne piken ne vazhdim.

V

Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne grupi i asamblesë se PDK-së e mbështesim këtë propozim vendim, por i lus komunat tjera te mos na vjedhin planin.

Lumturiye Bytyqi-Hasni, na si komitet për komunitete vitin e kaluar e kemi vizituar shkollën e Gadimes dhe aty si shqetësim drejtori e ka paraqitë braktisjen e shkollës nga 12 nxënës te komunitetit jo shumicë dhe ne nivel komune janë 69 nxënës, përpjektivë e DKA-së janë te shumta por te pa suksesshme por është dashtë qe këtu te paraqitet dhe sanksionet ndaj prindërve qe nuk i dërgojnë fëmijët ne shkollë.

Shahadije Bikliqi, tha se nëse e sheh këtë plan nga komunitete jo shumice janë 69 nxënës qe e kanë braktise shkollën dhe numër mjaft shqetësues. Cilat janë masat qe janë ndërmarr për këto raste edhe a është tentuar te përmirësohet kjo gjendje.

Rinor Murati, tha se sa i përket kësaj çështje, po e specifikoj një rast ku shumë fëmije dhe nxënës e braktisin shkollën, konsideroj qe duhet kushtuar vëmendje këtij fenomeni.

Alban Salihu, tha se ne si anëtar te kuvendit detyrohemi siç është situata tash për shkak të ndjeshmërinë e temës, me votuar për një dokument te përpiluar prej një drejtori qe e është përgjegjës për lëmshin qe ja ka shkaktuar arsimit ne Lipjan.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se është e drejte e secilit, anëtar dhe e juaja me votuar ose jo dhe nuk keni nevojë me arsyetuar votën, qytetaret janë ata qe e vlerësojnë a keni votuar drejt ose jo.

Rasim Hasani, tha se disa persona ne kuvend nuk e meritojnë përgjigjen time. Sa i përket planit ju tregova ne KPF, e ka bere një organizatë dhe disa komune e kane te ngjashme. Ligji na detyron ne fund si DKA, me filluar me proceduara penale. Besoj qe eshte ne j plan i mire.

Arsim Jashari, nëse një kompani e ka bërë. nuk i kane te gjitha komunat specifikat e njëjta.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 2 abstenime, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Lipjanit 2024-2027.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Besiana Sylja, tha se miratimi i planit dhe strategjisë një veprim i duhur dhe mirëpritur dhe e kam analizuar me kujdes, unë nuk po e shoh që janë bërë analiza nga vitet e kaluara po ashtu jeni thirrur në KAB, mirëpo pak përfillet apo fare hiç dhe kjo është një faktor që pak pritet. Sa përdorna me ngecje janë të identifikohem dhe çka ka parape ky plan? Unë kam edhe disa rekomandime, lirimi i personave me aftësi të kufizuara nga taksa e regjistrimit të pronës. Krijimi i fondeve për mbështetje financiare të OJQ-ve, që ofrojnë shërbime për persona me aftësi të kufizuara, si dhe krijimi i parkingjeve në hapësira publike të shërbimeve sociale.

Egzona Bytyqi, tha se në si grup e mbështesim këtë strategji dhe i kemi mbështet çdo herë. Kemi pas nevojë për një strategji, ajo që me interesoj është ofrimi i shërbimeve shëndetësore për këtë kategori. Është një game e gjere që do të ju ofrohet këtyre personave, ajo që me beri përshtypje identifikimi i aftësive të kufizuara në kohën e hershme, po ashtu realizimi i mamografit papa testit për gratë. Po ashtu trajnimi i stafin ke shume i mirëpritur, urojme që kjo të zbatohet he për neve ka qen shumë i mirëseardhur.

Nexhemdin Lekiqi, tha se e uroj drejtorin për këtë plan, uroj që sa më shpejtë me filluar me u implemetuar dhe me u zbatuar. Uroj që të kemi dhe evidence ta dimë numrin dhe rastet dhe do ta kemi me lehte që edhe të ndihmohen.

Rinor Murati, se sa i përket këtij plani behet fjalë për një kategori mjaft të ndjeshme të shoqërisë tone, që duhet të shtojmë kujdes të veçantë. Në KAB- ke edhe renovimi i QKMF-së për nevoja të shfrytëzimit të këtyre organizatave apo shoqatave. Krahas kësaj duhet të ju bëjmë qasje në institucione ku mungojnë për hapësirat e

pjerrinave ne vendet ku mungoje dhe ofrimi i ndihmës financiarë për kujdestaret apo asistentet.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, aprovoi propozimin

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për , aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Herolind Kozhani, tha se ne grupi i PDK-së, e mbështesim këtë propozim.

Albiona Tasholli, tha se ne grupi i LDK-së e mbështesim këtë propozim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 2 abstenime, aprovoi propozimin

VIII

Propozim vendim për miratimin e rezervës komunale për vitin 2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne e mbështesim si grup i PDK-së këtë propozim vendim, dhe kujdes me deklarata qe nuk po e mbështet buxhetin PDK-ja.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 13:00.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi